



Plani / Dotted Priloge / Priloge Received / Delivery		17 01 2022	2	viti god year
Organ / Qësia Organ / Jedinita Org / Unit	Id. Prof Id. Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity	
SKIMSHICK	196 / 2022		114	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.995/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.995/2021 të datës 02.12.2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna e Lipjanit, kundër Vendimit në numër 024 të datës 11.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.995/2021 e datës 02.12.2021 e parashtruar nga ankuesi**
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokollit 024 i datës 11.11.2021 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi Naser Mazreku sipas ndryshim dhe plotësimit të kontratës së datës 13.02.2020 është në vendin e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas nenit 4 paragrafit 1 nëpunësit profesional të shërbimit korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, në këtë rast përveç elementeve të marrëdhënies së punës si: *kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; dhe zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, mund të ndryshoj me ligj të veçantë elementet e tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës do të shqyrtoj ankesat vetëm për elementet e marrëdhënies së punës të cilat janë të rregulluara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Ndaj ankuesit Naser Mazreku, me datë 15.10.2021 mbikëqyrësi i tij ka paraqitur kërkesë me numër protokollit 024 për inicim të procedurës disiplinore me pretendim se supozohet se ankuesi ka bërë shkelje të rregullave të punës respektivisht ka bërë shkelje të aktit të brendshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës „Rregulla e brendshme për pajisjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit me numër të protokollit 0825 të datës 21.09.2020”.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 11.11.2021 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 024 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore **“Ndalimi 30% e pagës për periudhë tre muaj”** dhe në dispozitivin e dytë të vendimit i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm që ankuesit t’ia revokoj lejen e armës dhe që i njëjti mos të ketë drejtë në posedimin e armës.

Sipas këshillës juridike të cekur në vendimin e lartcekur, ankuesi kundër Vendimit me numër të protokollit 024 të datës 11.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5764/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 08.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit të datës 02.12.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 11.11.2021 i Komisionit Disiplinor; Ndryshimi dhe plotësimi i kontratës së punës i datës 13.02.2020; Kontratë pune për kohë të pacaktuar; Vendimi për themelimin e Komisionit Disiplinor i datës 19.03.2021; Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 20.10.2021; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 15.10.2021; Ftesë për intervistë i datës 15.10.2021; Deklarata e ankuesit e datës 05.10.2021; e-mai-at e datave 14.10.2021, 08.10.2021; Procesverbal i intervistimit i datës 18.10.2021; Flete kthesë e datës 19.11.2021; Rregulla e Brendshme për pajisjen dhe përdorimin e Armëve të Zjarrit e datës 21.09.2020 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, pasi ka shqyrtuar shkresën e datës 15.10.2021, me të cilën është iniciuar procedure disiplinore ndaj ankuesit me pretendimet se ankuesi supozohet se ka bërë shkelje të “Rregulla e brendshme për pajisjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit me numër të protokollit 0825 të datës 21.09.2020”, me datën 11.11.2021 Komisioni Disiplinor, ka nxjerr vendim numër protokollit 024 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore **„ndalim 30% e pagës për një periudhë tre (3) muaj”** me arsyetimin që nëpunësi Naser Mazreku ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.10, neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe në dispozitivin e dytë të vendimit i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm ankuesit t’ia revokoj lejen e armës dhe që i njëjti mos të ketë drejtë në posedimin e armës.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili nuk pajtohet me masën e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor sepse pretendon se kjo është në mos përputhje me shkeljen që e ka bërë gjithashtu e kundërshton edhe pikën dy të dispozitivit të vendimit që ti revokohet leja për armën zyrtare që të mos ketë të drejtë ta posedoj armën zyrtare, mirëpo ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e pranon që e ka harruar armën në shtëpi pa ndonjë qëllim të keq dhe pa asnjë prapavijë pasi që ka qenë i sëmurë, mirëpo Kolegji ka konstatuar se duke marr parasysh veprimet dhe mosveprimet e ankuesit, pakujdesin dhe moskujdesin e ankuesit gjatë bartjes së armës së zjarrit ka kryer shkelje të detyrave të punës të cilat janë të vërtetuara nga Komisioni Disiplinor me vendimin me numër të protokollit 024 të datë 11.11.2021 që ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të nenit 118 paragrafit 2 të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me të cilën përcaktohet se: *“Arma e zjarrit mund të përdoret vetëm kur siguria e institucionit korrektues, apo siguria e personave kërcënohet nga brenda dhe jashtë institucionit korrektues”*, ndërsa ankuesi më datë 18.10.2021 para Komisionit Disiplinor ka deklaruar se i ka shfrytëzuar njëzet (20) municion/fishekë zjarr në mal me arsyetim se në certifikim nuk ka qenë shumë i saktë, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se vetë ankuesi ka pranuar që ka bërë një veprim të tillë i cili rrjedhimisht është në kundërshtim me rregullat e brendshme të institucionit.

Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës dhe deklaratimet e lartcekura, ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit siç parashihet me nenin 25 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***“1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 27 të këtij ligji „Zyrtari publik është i obliguar të menaxhojë me kujdes pasurinë shtetërore, që i vihet në detyrim për ushtrimin e detyrës dhe të përdorë atë vetëm për qëllimin e përcaktuar me ligj dhe sipas rregullave të brendshme të institucionit. 2. Zyrtarit publik nuk i lejohet të shfrytëzojë pasurinë shtetërore si mjet për zhvillimin e veprimtarisë personale ekonomike ose të aktiviteteve të paligjshme. 3. Zyrtari publik është i detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të tij të punës, si dhe sipas nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë „zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”***.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i referuar fakteve të lartcekura ka konstatuar se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit Naser Mazreku është bere në përputhje me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”***, dhe me rastin e shqiptimi të masës disiplinore ***„Ndalim i 30% e pagës për tre (3) muaj”***, dhe rekomandimit për t’ia revokuar lejen e armës dhe që i njëjti mos të ketë drejtën e posedimit të armës nga Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës është bere ne pajtim me nenin 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të nenit 13 të Rregullores (QKR) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji po ashtu ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 50 të Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: “1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit” dhe 2. “Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer”, sepse komisioni disiplinor ka arritur të shqyrtoj të gjitha provat dhe faktet duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese, rrjedhimisht vendimi i Komisionit Disiplinor është në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se „Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ngase komisioni disiplinor ka konstatuar drejte gjendjen faktike dhe juridike respektivisht ka arritur të konstatojë drejtë se ankuesi me veprimet e tij ka kryer shkelje disiplinore gjegjësisht shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjor sipas neni 46 paragrafit 3 nën paragrafit 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A nr.995/2021

Valentina Kaçandoll Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

